



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 719 Prot.

Tiranë, më 31.05.2024

VENDIM

Nr. 8, Datë 31/05/2024

PËR

**PËRCAKTIMIN E KARAKTERISTIKAVE TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR
ZGJEDHJET E AUTORITETEVE DHE ORGANEVE DREJTUESE NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Në mbështetje të pikave 1 dhe 2, të nenit 131 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, si dhe të nenit 29 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, të miratuar me Vendimin nr. 17 datë 29.03.2024 të Senatit Akademik të UART, në mbledhjen e datës 31.05.2024, pasi diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e karakteristikave të fletëve të votimit për personelin akademik, si më poshtë:

- Fletë votimi për Rektor, ngjyra jeshile, format A4, shkrimi Times New Roman, Bold, size 16;
- Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Kryesore, ngjyra portokalli, format A4, shkrimi Times New Roman, Bold, size 16;
- Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Bazë, ngjyra rozë, format A4, shkrimi Times New Roman, Bold, size 16;
- Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik, ngjyra e bardhë, format A4, shkrimi Times New Roman, Bold, size 16.

2. Karakteristikat e fletëve të votimit për studentët janë si më poshtë:

- Fletë votimi për Rektor, ngjyra e kuqe, format A4, shkrimi Times New Roman, Bold, size 16;
- Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Kryesore, ngjyra blu, format A4, shkrimi Times New Roman, Bold, size 16;
- Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve ngjyra e verdhë, format A4, shkrimi Times New Roman, Bold, size 16.

3. Ky vendim të dërgohet pranë Komisioneve Zgjedhore në Fakultete dhe Administratorese të UART për mundësimin e bazës materiale me fletët e votimit.

4. Ky vendim të publikohet në faqen elektronike të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Suela Agolli

Anëtar



Shpëtim Kërçova

Anëtar



Adela Kusuri

Anëtar



Sara Caca

Anëtar



Orges Malaj

Kryetar



Redjan Mulla

Sekretar

